



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 1812



Fushë-Arrëz, më 25.06.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr. 19, datë 24/06/2025, Relacionit e dokumentave shoqërues në lidhje me Projektvendimin "Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Maj 2025"

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019. "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu IV, pika 2 të Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" të ndryshuar, Vendim Nr.5, datë 23.02.2018 "Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, me përjashtim të pikës 1,6,7, që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për uljen e varfërisë. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kujdesin social.

Situata financiare : Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Maj 2025, 30 familje, me fond 120,666 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,966,429 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 118,630 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha shtresave të varfra në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi publik

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 25/06/2025, shqyrtoi projektvendimin nr.19, datë 24/06/2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me projektvendimin “Mbi fondin e kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% Maj 2025” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Pavlin Qafa  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 1812 prot.

Fushë-Arrëz, më 25.06.2025


PËR : KËSHILLIN E BASHKISË
FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin “Për miratimin e listës së përfituesve të Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Maj 2025”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 26.06.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar; Rregullores për Funksionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut në mbledhjen e datës 25.06.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Tereze Dema, mori në shqyrtim projektvendimin për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Maj 2025, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Përgjegjësja e Sektorit të Çështjeve Sociale, Znj Klotilda Curri, thotë se në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndhmë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfëra ku bazohemi edhe të VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kritereve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6%, është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Fushë-Arrëz. Ndërkohë, Përgjegjësja e Sektorit të Çështjeve Sociale, Znj Klotilda Curri shpjegoi se për muajin **MAJ 2025**, **30** familje, me fond **120,666** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **1,966,429** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën **118,630** lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 50,758 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Përgjegjësjë e Sektorit të Çështjeve Sociale në Bashki, Znj Klotilda Curri, shpjegon se nuk shtohet në bllok-ndihmën e 6% asnjë familje apo individ për muajin Maj 2025 dhe se largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Valter Prela (Njësia Administrative Fierzë) për riaplikim në Ndihmë Ekonomike.

Znj. Curri gjithashtu tregon se trajtohen me ndihmën ekonomike prej 6% :

Të gjitha familjet që mund të dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme:

1. Liza Ndue Cenaj
2. Marjana Ded Kacoli
3. Mark Pjeter Marku
4. Misire Shaban Miftaraj
5. Vogel Mark Shpendi
6. Pranvera Nikoll Prebiracevic

Franc Doda, anëtar i komisionit, i njohur edhe më parë me materialin, shprehet se është dakord me listën emrore të përfituesve të Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Maj 2025.

Pavlin Qafa, anëtar i komisionit, shprehet se është dakord me propozimet e bera për familjet përfituese të ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 % , le të përfitojnë të gjitha familjet që plotësojnë kritet e paracaktuara me VKB.

Franc Doda anëtar i komisionit, thekson në mënyrë të perseritur se duhet të kontrollohen individët atje ku jetojnë dhe si i kanë kushtet në mënyrë që të trajtohen ato familje që janë në nevojë dhe që plotësojnë kriteret e përfitimit.

Tereze Dema, anetare e komisionit shprehet se është dakord me propozimet e bera për familjet përfituese të ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 %. Duhet të ndihmohen edhe familje të tjera në nevojë për aplikim dhe të përfitojnë sipas kriterëve të miratuara nga Keshilli Bashkiak.

Anëtarët e komisionit kërkuar domosdoshmërisht zbatimin e kriterëve të përfitimit të 6%.


Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e dërguar atë për miratim në mbledhjen e datës 26.06.2025 të Këshillit Bashkëliak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

Franc Doda



Paylin Qafa



Tereze Dema

